 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>		<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (3 x 4)
1	Implementimi i një sistemi faturimi për faturimin e abonentëve	Copë	1		
2	Ofrimin e shërbimit të fiskalizimit për një periudhë 10-mujore dhe integrimin e tij me sistemin e faturimit	Muaj	10		
2	Migrimin e të dhënave (database) të ish-ujësjellës kanalizimeve Peshkopi, Bulqizë, Mat dhe Klos	Copë	1		
4	Shërbimeve i pagesave nëpërmjet përdorimit të Web Service dhe ofrimin e tyre për të gjithë kanalet e pagesave	Copë	1		
5	Trajnimin e përdoruesve të sistemit të faturimit	Copë	1		
6	Mirëmbajtjen e sistemit të faturimit për një periudhë 10 mujore	Muaj	10		
Çmimi total (Shërbimet)					
Çmimi Neto pa TVSH					

TVSH (%)	
Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik]
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objekti: *“Implementimi dhe mirëmbajtje të sistemit të faturimit, migrimi i të dhënave ofrimi shërbimit dhe integrimi i sistemit të fiskalizimit”.*

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër Sh. A.

• Situata në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër

Bazuar në; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.302, datë 11.05.2022, *“Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”*, Marrëveshjen *“Për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës-Kanalizime Dibër Sh.a datë 15.07.2022”*, lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe; Bashkisë së Dibrës, Bashkisë së Bulqizës, Bashkisë Klos dhe Bashkisë Mat, është krijuar shoqëria e re aksionare: "Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër Sh.a" (Shoqëria) me numër nipti M27109701L, me datë regjistrimi 01.09.2022 në Q.K.B., me qendër në Bulqizë, e cila aktualisht numëron rreth 24,500 abonentë. Shoqëria e re në bazë duhet të ofrojë shërbimin për abonentët familjarë dhe jofamiljarë duke gjeneruar faturën e unifikuar për abonentët. Përsa më sipër Shoqëria do duhet të implemetojë një sistem faturimi për faturat e abonentëve dhe ndërkohë do të duhet të transferojë të gjithë të dhënat (database) të ish ujësjellës kanalizimeve Peshkopi, Bulqizë, Mat dhe Klos.

1. Objektivat dhe detyrat që duhet të arrihen nga Kontraktori

- A. Implementimi i një sistemi faturimi për faturimin e abonentëve, përpunimin e dhënave të abonentëve dhe menaxhimin e tyre;
- B. Ofrimin e shërbimit të fiskalizimit për një periudhë 10-mujore dhe integrimin e tij me sistemin e faturimit;
- C. Migrimin e të dhënave (database) të ish-ujësjellës kanalizimeve Peshkopi, Bulqizë, Mat dhe Klos;
- D. Vendosja e shërbimeve të pagesave nëpërmjet përdorimit të Web Service dhe ofrimin e tyre për të gjithë kanalet e pagesave;

-
- E. Trajnimin e përdoruesve të sistemit të faturimit;
 - F. Mirëmbajtjen e sistemit të faturimit për një periudhë 10 mujore.

SISTEMI I FATURIMIT

1. Moduli i Faturimit dhe Arkëtimit

Moduli i Faturimit dhe Arkëtimit duhet të ofrojë funksionalitetet e mëposhtme:

1. Modul për rregjistrin e abonentëve dhe profilin e abonentit (familjar dhe jofamiljar);
2. Modul për regjistrimin e matësave të ujit
3. Modul për hedhjen e leximeve;
4. Modul për faturimin e abonentëve familjar dhe jofamiljar;
5. Modul për krijimin e artikujve dhe planeve tarifore;
6. Modul për arkëtimin e faturave të abonenteve familjarë dhe jofamiljarë;
7. Moduli i pagesave online me posten, bankat dhe easypay, etj. nëpërmjet web services;
8. Integrim me sistemet e pagesave që vijnë nga palët e treta;
9. Të ofrojë mundësi integrimi me sisteme fiskalizimi, etj;
10. Të gjenerojë raporte periodike.

1.1 Moduli për krijimin e artikujve dhe planeve tarifore

Artikujt përfshijnë shërbimet që sistemi u ofron abonentëve ose produktet fizike që përdoren nga Shoqëria për qëllime të ndryshme. Plani tarifor përshkruan mënyrën se si do të tarifohen klientët që i përkasin një kategorie të caktuar. Kjo ndarje duhet bërë pasi një konsumator në kategorinë “Familjar” mund t’i ofrohen artikuj të ndryshëm me një klient në kategorinë “Jofamiljar”.

Çdo plan tarifor diferenkohet nga artikujt që do të përshijë, pra janë pikërisht artikujt dhe të dhënat për çmimet, sasinë, frekuencën e tarifimit, që përcaktojnë një plan tarifor.

Sistemi duhet të mundësojë krijimin e planeve tarifore nga nderfaqja në mënyrë të lehtë për përdoruesit. Për planet e tarifimit duhet të jete mundësia e përcaktimit të frekuencës së tarifimit.

1.2 Modul për rregjistrimin/regjistrin e abonentëve dhe profilin e abonentit

Moduli i Faturimit dhe Arkëtimit duhet të përfshijë funksionet për krijimin dhe rregjistrimin e abonentëve. Për çdo abonent ekzistues ose të ri sistemi duhet të përmbajë minimalisht këto fusha:

- *Emri i abonentit*
- *Nr. Dokumentit – ID e abonentit*
- *Datë/Nr. kontrate*
- *Nr. Familjarëve – përkon me numrin e pjestarëve në rastin e një familjeje*
- *Kategoria e Konsumatorit*
- *Adresa*
- *Vendodhja në hartë*
- *Plani tarifor*

-
- NUIS – në rastin e bizneseve ose institucioneve publike
 - Të dhënat e matësit të ujit të abonentit
 - Statuset e abonentit - aktiv, pasiv, prerje, njoftim debitori, etj.

1.3 Modul per regjistrimin e matësive të ujit

Matësit përfaqësojnë pajisjet teknike që vendosen në ambientet e konsumatorëve/ abonentëve dhe bëjnë matjen e sasisë së konsumuar të ujit të pijshëm. Një matës uji mund të krijohet gjatë regjistrimit së një abonenti të ri ose mund të krijohet në një mënyrë të pavarur, dhe ti caktohet më pas një abonenti.

Informacioni që duhet të plotësohet për matësin e ri duhet të përmbajë:

- Numri i matësit – numër unik për identifikimin dhe referimin e matësit në sistem
- Fillimi i numërimit – përcakton vlerën fillestare të matësit në momentin që do të vendoset te një klient.
- Tipi i matësit (marka e tij)
- Data e plumbosjes dhe data e prodhimit – i referohet datës kur është prodhuar dhe plumbosur aparati matës
- Lloji i matësit
- Diametri

Në çdo moment Shoqëria duhet të ketë mundësi të njihet dhe kontrollojë raportet mbi matësat e regjistruar, matësat e instaluar, ndërrimet e matësive, etj

1.4 Modul per hedhjen e leximeve

Në këtë modul duhet të menaxhohet printimi i listave për leximin e abonentëve, hedhja e leximeve nga operatorët, kryerja e kontrolleve përpara se të bëhet mbyllja e periudhës së faturimit.

1.5 Modul për faturimin e abonentëve

Në modulën e faturave duhet të jepet informacion për periudhat e faturimit. Periudha e faturimit përfshin një periudhë kohore të caktuar, zakonisht një mujore, brenda të cilës do të agregohen të dhënat mbi konsumin e ujit nga abonentët brenda kësaj periudhe, me rezultat final gjenerimin e faturave për ta. Këtu duhet të jepet informacion për numrin e abonentëve të faturuar vlerën e faturimit, etj.

1.6 Modul për arkëtimin e faturave të abonentëve

Moduli i arkës është një nga pikat kryesore të sistemit të faturimit. Në këtë modul duhet të menaxhohen të gjitha arkëtimet e realizuara nga abonentët nëpërmjet arkave, bankave ose palëve të treta të tjera, krijimi i mandateve të arkëtimin, krijimi i njësisive të reja të arkave ose bankave etj.

Për çdo veprim arke duhet të ruhet operatori, i cili realizon arkëtimin, data dhe ora e saktë e veprimit.

Sistemi duhet të mundësojë regjistrimin e likuidimit të plotë dhe të pjesëshëm të faturave.

1.7 Raportet

Sistemi duhet të jetë i pajisur me raporte të shumta, të cilat japin informacion mbi:

- Faturimin sipas zonave
- Faturimin sipas klasave të shërbimit
- Faturimin sipas kategorive të abonentëve
- Debinë e detajuar të abonentëve
- Debinë sipas Kategorisë të abonentëve
- Debinë sipas klasave të shërbimit
- Raporte mbi konsumin
- Raporte krahasuese mbi faturimin në periudha të ndryshme kohore
- Raporte për matësit e ujit të vendosur në periudhe kohore
- Raporte të detajuara për arkëtimin, etj

Raportet duhet të eksportohen në pdf dhe në excel.

1.8 Moduli i manaxhimit te perdoruesve

Sistemi duhet të ketë modul të qendëruar për menaxhimin e përdoruesve në sistem duke mundësuar menaxhimin e roleve, të drejtave të tyre në sistem, përdoruesve, përcaktimin e tyre nëpër role, etj. Sistemi të ofrojë funksionalitet për të përcaktuar zonat IP nga ku mund ta aksesojnë sistemin përdorues të caktuar.

2. Integrimi

Sistemi të përbëhet nga module të cilat janë të integruara mes tyre, që ndajnë të njëjtin modul të drejta përdoruesish dhe sigurie, modul raportimi, modul konfigurimi parametrash, etj. Sistemi duhet të integrohet me kanalet e pagesave elektronike të cilat janë sisteme informatike të palëve të treta që komunikojnë nëpërmjet web shërbimeve të veçanta për secilën palë. Moduli i faturimit dhe arkëtimin të jetë i kompatibël për integrimin me module e fiskalizimi për fiskalizimin e të gjithë faturave të abonentëve.

3. Afati i implementimit

Sistemi i përbërë nga moduli i Faturimit dhe Arkëtimin së bashku me migrimin e të dhënave duhet të implementohet në cloud dhe të jetë i përdorshëm nga Shoqëria brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

4. Trajnimi dhe manuallet

Sistemi duhet të shoqerohet me manuallet përkatëse në gjuhën shqipe. Kontraktori duhet të realizojë trajnimin e përdoruesve në zyrat e Shoqërisë ose online.

5. Moduli i gjurmëve (log) dhe siguri

Sistemi duhet të ofrojë funksionalitete për monitorimin dhe auditimin e të gjithë veprimeve në sistem. Për çdo veprim duhet të ruhet data, autori (përdoruesi), rekordi i ndryshuar, fushat e ndryshuara për cdo rekord, vlerat para modifikimit dhe ajo pas modifikimit. Gjurmët e auditimit

duhet të jenë të aksesueshme por të pamodifikueshme nga ndërfaqja e sistemit.

Sistemi duhet të ofrojë të gjithë parametrat e sigurisë lidhur me autentikimin dhe kredencialet e llogarive, si vlefshmërinë dhe kompleksitetin e fjalëkalimeve të përdoruesve, skadimin e fjalëkalimeve, njoftim për afatin e skadimit etj.

6. Mirëmbajtja e Sistemit të Faturimit Arkëtimit

Kontraktori do duhet të ofrojë mirëmbajtjen e sistemit të faturimit të implementuar për një periudhë 10-mujore duke nisur nga data e përfundimit të implementimit të tij.

7. Kërkesa te përgjithshme të Sistemit të Faturimit

- Sistemi duhet të implementohet në cloud.
- Sistemi duhet të ofrohet tërësisht web based, pra çdo përdorues duhet të ketë mundësinë ta përdorë atë nga web.
- Sistemi i ofertuar duhet të jetë COTS (Commercial off the Shelf Software).
- Çmimi i sistemit të ofruar nuk duhet të ketë varësi nga numri i përdoruesve.
- Çmimi i sistemit të ofruar nuk duhet të ketë varësi nga krijimi i ambientit test.
- Sistemi duhet të jetë tërësisht në gjuhën shqipe
- Funkcionalitetet e sistemit duhet të arrihen me parametrizime dhe konfigurime. Parametrizimet dhe konfigurimet, duhet të jenë të mundura të realizohen nga ndërfaqja e përdoruesit administrator të sistemit, dhe jo me ndryshime në kod apo databazë.
- Sistemi duhet të ruajë të dhënat në një bazë të dhënash relacionale, pa licence dhe pa kufizim në numër përdoruesish, volum të dhënash apo kufizime të tjera. Çdo kosto shtese per rritje te numrit te perdoruesve do te perballohet nga Kontraktori.
- Në çdo modul dhe çdo formë të tij, aplikacioni duhet të mundësojë export masiv të dhënash në bazë dokumentash excel ose csv.
- Sistemi nuk duhet të jetë i izoluar për të mos lejuar zhvillime apo përshtatje të mëtejshme, por duhet të ofrojë API për të shtuar module të tjera në të ardhmen.

SISTEMI I FISKALIZIMIT

Sistemi i fiskalizimit duhet të ofrojë funksionalitetet e mëposhteme:

- a) Të regjistrojë shpejt dhe lehtë dokumentacionin ku përfshihen faturat elektronike, faturat pa para ne dore, faturat me para ne dore, faturat shoqeruese dhe dhe veprimet e arkave.
- b) Të jetë i integruar me sistemin e faturimit.
- c) Faturat për të gjithë abonentët të merren automatikisht nga sistemi i faturimit dhe të fiskalizohen.
- d) Faturat për veprimet të cilat mund të mos përfshihen në sistemin e faturimit, si psh lidhje të reja, ndryshim emri etj. të ketë mundësi të regjistrohen manualisht.
- e) Të dërgojë në shërbimin e fiskalizimit pagesat e faturave elektronike, të cilat nuk raportohen nga bankat e nivelit të dytë.
- f) Të gjenerojë raporte dhe informacion mbi faturat të cilat janë fiskalizuar ose jo.

Operatori Ekonomik duhet të ketë zgjidhjen e certifikuar të software-it në formën e një aplikacioni individual, ose një sistemi kompjuterik të integruar, ose një aplikacion Cloud, i cili mundëson:

- krijimin e një fature, një fature shoqëruese dhe vendosjen e të gjithë elementeve të nevojshëm;
- vlefshmërinë e operatorit që lëshon faturën ose faturën shoqëruese;
- dërgimin e sigurt të të dhënave në sistemin qendror, duke përdorur certifikatën elektronike;
- lëshimin dhe pranimin e faturave elektronike;
- transmetimin automatik të të dhënave në administratën tatimore dhe marrjen e mesazhit;
- konfirmues nga administrata tatimore, pas verifikimit automatik të secilës faturë individuale ose fature shoqëruese;
- ruajtjen e të dhënave të faturave ose të faturave shoqëruese;
- gjenerimin e numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF) dhe numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës shoqëruese (NSLFSH);
- gjenerimin e kodit QR;
- printimin e faturës ose thjesht kodit QR, në situata të përcaktuara në ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”;
- sigurojnë shkëmbimin e të dhënave në kohë reale dhe me autentifikim të sigurt të pajisjeve fiskale ekzistuese ose sistemit të fiskalizimit;

Funksione të tjera që duhet të ketë programi:

1. Bazat e të dhënave, të jenë të pa-aksesueshme jashtë këtij sistemi
2. Të ofroje mundësinë për të përcaktuar autorizime të detajuara se cili përdorues apo rol të mund të shikojë, administrojë llogari apo element ose ambiente të caktuara
3. Të ofrojë një mekanizëm për administrimin e privilegjeve në mënyrë të detajuar për funksionalitete të ndryshme. Në këtë mënyrë çdo përdorues ka akses vetëm tek ambientet, modulet apo raportet që i janë përcaktuar më parë nga një përdorues administrator.
4. Të ofroje mundësinë që një përdorues i caktuar të mund të shikojë vetëm veprimet e tij dhe jo veprimet e të tjerëve.
5. Të ofroje mundësinë për të përcaktuar autorizime të detajuara se cili përdorues apo rol të mund të shikojë, administrojë llogari apo element ose ambiente të caktuara
6. Të mundesojë regjistrimin e çdo krijimi, anulimi apo modifikimi dokumenti nga ana e përdoruesve.
7. Të mundesojë regjistrimin e datës, orës, përdoruesit dhe të IP-së së atij që ka kryer veprimin gjatë regjistrimit të auditimit.
8. Të mundesojë historikun e veprimeve, pra të mund të shihen dokumentet si kanë qenë para modifikimit.
9. Backup. Të dhënat të ruhen çdo ditë nëpërmjet një procesi automatik backup.

Shtojca 6

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: “Implementimi dhe mirëmbajtje të sistemit të faturimit, migrimi i të dhënave ofrimi shërbimit dhe integrimi i sistemit të fiskalizimit”.

Afatet e ekzekutimit: deri në 10 muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.

Shërbimet	Përshkrimi	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
1	Implementimi i një sistemi faturimi për faturimin e abonentëve	Sipas Specifikimeve teknike	Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kontratës
2	Ofrimin e shërbimit të fiskalizimit për një periudhë 10-mujore dhe integrimin e tij me sistemin e faturimit	Sipas Specifikimeve teknike	Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kontratës
3	Migrimin e të dhënave (database) të ish-ujësjellës kanalizimeve Peshkopi, Bulqizë, Mat dhe Klos	Sipas Specifikimeve teknike	Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kontratës
4	Shërbimeve të pagesave nëpërmjet përdorimit të Web Service	Sipas Specifikimeve teknike	10 muaj pas implementimit të sistemit
5	Trajnimin e përdoruesve të sistemit të faturimit	Sipas Specifikimeve teknike	Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kontratës
6	Mirëmbajtjen e sistemit të faturimit për një periudhë 10 mujore	Sipas Specifikimeve teknike	10 muaj pas implementimit të sistemit

Shtojca 7

TERMAT E REFERENCES

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër Sh. A.

- **Situata në Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër**

Bazuar në; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.302, datë 11.05.2022, “Për Politikën Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, Marrëveshjen “Për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetllës-Kanalizime Dibër Sh.a datë 15.07.2022”, lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe; Bashkisë së Dibrës, Bashkisë së Bulqizës, Bashkisë Klos dhe Bashkisë Mat, është krijuar shoqëria e re aksionare: "Shoqëria Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Dibër Sh.a" (Shoqëria) me numër nipti M27109701L, me datë regjistrimi 01.09.2022 në Q.K.B., me qendër në Bulqizë, e cila aktualisht numëron rreth 24,500 abonentë. Shoqëria e re në bazë duhet të ofrojë shërbimin për abonentët familjarë dhe jofamiljarë duke gjeneruar faturën e unifikuar për abonentët. Përsa më sipër Shoqëria e re do duhet të impletojë një sistem faturimi për faturat e abonentëve dhe ndërkohë do të duhet të transferojë të gjithë të dhënat (database) të ish ujësjetllës kanalizimeve: Peshkopi, Bulqizë, Mat dhe Klos.

1. Objektivat dhe detyrat që duhet të arrihen nga Kontraktori

- A. Implementimi i një sistemi faturimi për faturimin e abonentëve, përpunimin e dhënave të abonentëve dhe menaxhimin e tyre;
- B. Ofrimin e shërbimit të fiskalizimit për një periudhë 10-mujore dhe integrimin e tij me sistemin e faturimit;
- C. Migrimin e të dhënave (database) të ish-ujësjetllës kanalizimeve Peshkopi, Bulqizë, Mat dhe Klos;
- D. Vendosija e shërbimeve të pagesave nëpërmjet përdorimit të Web Service dhe ofrimin e tyre për të gjithë kanalet e pagesave;
- E. Trajnimin e përdoruesve të sistemit të faturimit;
- F. Mirëmbajtjen e sistemit të faturimit për një periudhë 10 mujore.

SISTEMI I FATURIMIT

1. Moduli i Faturimit dhe Arkëtimit

Moduli i Faturimit dhe Arkëtimit duhet të ofrojë funksionalitetet e mëposhtme:

11. Modul për regjistrin e abonentëve dhe profilin e abonentit (familjar dhe jofamiljar);
12. Modul për regjistrimin e matësave të ujit
13. Modul për hedhjen e leximeve;
14. Modul për faturimin e abonentëve familjar dhe jofamiljar;
15. Modul për krijimin e artikujve dhe planeve tarifore;
16. Modul për arkëtimin e faturave të abonenteve familjarë dhe jofamiljarë;
17. Moduli i pagesave online me posten, bankat dhe easypay, etj. nëpërmjet web services;
18. Integrim me sistemet e pagesave që vijnë nga palët e treta;
19. Të ofrojë mundësi integrimi me sisteme fiskalizimi, etj;
20. Të gjenerojë raporte periodike.

1.1 Moduli per krijimin e artikujve dhe planeve tarifore

Artikujt përfshijnë shërbimet që sistemi u ofron abonentëve ose produktet fizike që përdoren nga Shoqëria për qëllime të ndryshme. Plani tarifor përshkruan mënyrën se si do të tarifohen klientët që i përkasin një kategorie të caktuar. Kjo ndarje duhet bërë pasi një konsumator në kategorinë “Familjar” mund t’i ofrohen artikuj të ndryshëm me një klient në kategorinë “Jofamiljar”.

Çdo plan tarifor diferencohet nga artikujt që do të përshijë, pra janë pikërisht artikujt dhe të dhënat për çmimet, sasinë, frekuencën e tarifimit, që përcaktojnë një plan tarifor.

Sistemi duhet të mundësojë krijimin e planeve tarifore nga nderfaqja në mënyrë të lehtë për përdoruesit. Për planet e tarifimit duhet të jete mundësia e përcaktimit të frekuencës së tarifimit.

1.2 Modul për rregjistrimin/regjistrin e abonentëve dhe profilin e abonentit

Moduli i Faturimit dhe Arkëtimit duhet të përfshijë funksionet për krijimin dhe rregjistrimin e abonentëve. Për çdo abonent ekzistues ose të ri sistemi duhet të përmbajë minimalisht këto fusha:

- *Emri i abonentit*
- *Nr. Dokumentit* – ID e abonentit
- *Datë/Nr. kontrate*
- *Nr. Familjarëve* – përkon me numrin e pjestarëve në rastin e një familjeje
- *Kategoria e Konsumatorit*
- *Adresa*
- *Vendodhja në hartë*
- *Plani tarifor*
- NUIS – në rastin e bizneseve ose institucioneve publike
- Të dhënat e matësit të ujit të abonentit
- Statuset e abonentit - aktiv, pasiv, prerje, njoftim debitori, etj.

1.3 Modul per regjistrimin e matësive të ujit

Matësit përfaqësojnë pajisjet teknike që vendosen në ambientet e konsumatorëve/ abonentëve dhe bëjnë matjen e sasisë së konsumuar të ujit të pijshëm. Një matës uji mund të krijohet gjatë regjistrimit së një abonentit të ri ose mund të krijohet në një mënyrë të pavarur, dhe ti caktohet më pas një abonentit.

Informacioni që duhet të plotësohet për matësin e ri duhet të përmbajë:

- Numri i matësit – numër unik për identifikimin dhe referimin e matësit në sistem
- Fillimi i numërimit – përcakton vlerën fillestare të matësit në momentin që do të vendoset te një klient.
- Tipi i matësit (marka e tij)
- Data e plumbosjes dhe data e prodhimit – i referohet datës kur është prodhuar dhe plumbosur aparati matës
- Lloji i matësit
- Diametri

Në çdo moment Shoqëria duhet të ketë mundësi të njihet dhe kontrollojë raportet mbi matësat e regjistruar, matësat e instaluar, ndërrimet e matësive, etj

1.4 Modul për hedhjen e leximeve

Në këtë modul duhet të menaxhohet printimi i listave për leximin e abonentëve, hedhja e leximeve nga operatorët, kryerja e kontroleve përpara se të bëhet mbyllja e periudhës së faturimit.

1.5 Modul për faturimin e abonentëve

Në modulën e faturave duhet të jepet informacion për periudhat e faturimit. Periudha e faturimit përfshin një periudhë kohore të caktuar, zakonisht një mujore, brenda të cilës do të agregohen të dhënat mbi konsumin e ujit nga abonentët brenda kësaj periudhe, me rezultat final gjenerimin e faturave për ta. Këtu duhet të jepet informacion për numrin e abonentëve të faturuar vlerën e faturimit, etj.

1.6 Modul për arkëtimin e faturave të abonentëve

Moduli i arkës është një nga pikat kryesore të sistemit të faturimit. Në këtë modul duhet të menaxhohen të gjitha arkëtimet e realizuara nga abonentët nëpërmjet arkave, bankave ose palëve të treta të tjera, krijimi i mandateve të arkëtimin, krijimi i njësisë të reja të arkave ose bankave etj.

Për çdo veprim arke duhet të ruhet operatori, i cili realizon arkëtimin, data dhe ora e saktë e veprimit.

Sistemi duhet të mundësojë regjistrimin e likuidimit të plotë dhe të pjesshëm të faturave.

1.7 Raportet

Sistemi duhet të jetë i pajisur me raporte të shumta, të cilat japin informacion mbi:

- Faturimin sipas zonave
- Faturimin sipas klasave të shërbimit
- Faturimin sipas kategorive të abonentëve
- Debinë e detajuar të abonentëve
- Debinë sipas Kategorisë të abonentëve
- Debinë sipas klasave të shërbimit
- Raporte mbi konsumin
- Raporte krahasuese mbi faturimin në periudha të ndryshme kohore
- Raporte për matësit e ujit të vendosur në periudhe kohore
- Raporte të detajuara për arkëtimin, etj

Raportet duhet të eksportohen në pdf dhe në excel.

1.8 Moduli i menaxhimit të përdoruesve

Sistemi duhet të ketë modul të qendëruar për menaxhimin e përdoruesve në sistem duke mundësuar menaxhimin e roleve, të drejtave të tyre në sistem, përdoruesve, përcaktimin e tyre nëpër role, etj.

Sistemi të ofrojë funksionalitet për të përcaktuar zonat IP nga ku mund ta aksesojnë sistemin përdorues të caktuar.

A. Inegrimi

Sistemi të përbëhet nga module të cilat janë të integruara mes tyre, që ndajnë të njëjtin modul të drejta përdoruesish dhe sigurie, modul raportimi, modul konfigurimi parametrash, etj. Sistemi duhet të integrohet me kanalet e pagesave elektronike të cilat janë sisteme informatike të palëve të treta që komunikojnë nëpërmjet web shërbimeve të veçanta për secilën palë. Moduli i faturimit dhe arkëtimit të jetë i kompatibël për integrimin me module e fiskalizimi për fiskalizimin e të gjithë faturave të abonentëve.

B. Afati i implementimit

Sistemi i përbërë nga moduli i Faturimit dhe Arkëtimit së bashku me migrimin e të dhënave duhet të implementohet në cloud dhe të jetë i përdorshëm nga Shoqëria brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

C. Trajnimi dhe manualët

Sistemi duhet të shoqerohet me manualët përkatëse në gjuhën shqipe. Kontraktori duhet të realizojë trajnimin e përdoruesve në zyrat e Shoqërisë ose online.

D. Moduli i gjurmëve (log) dhe sigurisë

Sistemi duhet të ofrojë funksionalitete për monitorimin dhe auditimin e të gjithë veprimeve në sistem. Për çdo veprim duhet të ruhet data, autori (përdoruesi), rekordi i ndryshuar, fushat e ndryshuara për cdo rekord, vlerat para modifikimit dhe ajo pas modifikimit. Gjurmët e auditimit duhet të jenë të aksesueshme por të pamodifikueshme nga ndërfaqja e sistemit.

Sistemi duhet të ofrojë të gjithë parametrat e sigurisë lidhur me autentikimin dhe kredencialet e llogarive, si vlefshmërinë dhe kompleksitetin e fjalëkalimeve të përdoruesve, skadimin e fjalëkalimeve, njoftim për afatin e skadimit etj.

E. Mirëmbajtja e Sistemit të Faturimit Arkëtimit

Kontraktori do duhet të ofrojë mirëmbajtjen e sistemit të faturimit të implementuar për një periudhë 10-mujore duke nisur nga data e përfundimit të implementimit të tij.

F. Kërkesa të përgjithshme të Sistemit të Faturimit

- Sistemi duhet të implementohet në cloud.
- Sistemi duhet të ofrohet tërësisht web based, pra çdo përdorues duhet të ketë mundësinë ta përdorë atë nga web.
- Sistemi i ofertuar duhet të jetë COTS (Commercial off the Shelf Software).
- Çmimi i sistemit të ofruar nuk duhet të ketë varësi nga numri i përdoruesve.
- Çmimi i sistemit të ofruar nuk duhet të ketë varësi nga krijimi i ambjentit test.
- Sistemi duhet të jetë tërësisht në gjuhën shqipe

- Funksionalitetet e sistemit duhet të arrihen me parametrizime dhe konfigurime. Parametrizimet dhe konfigurimet, duhet të jenë të mundura të realizohen nga ndërfaqja e përdoruesit administrator të sistemit, dhe jo me ndryshime në kod apo databazë.
- Sistemi duhet të ruajë të dhënat në një bazë të dhënash relacionale, pa licence dhe pa kufizim në numër përdoruesish, volum të dhënash apo kufizime të tjera. Çdo kosto shtese per rritje te numrit te perdoruesve do te perballohet nga Kontraktori.
- Në çdo modul dhe çdo formë të tij, aplikacioni duhet të mundësojë export masiv të dhënash në bazë dokumentash excel ose csv.
- Sistemi nuk duhet të jetë i izoluar për të mos lejuar zhvillime apo përshtatje të mëtejshme, por duhet të ofrojë API për të shtuar module të tjera në të ardhmen.

SISTEMI I FISKALIZIMIT

Sistemi i fiskalizimit duhet te ofroje funksionalitetet e meposhteme:

- g) Të regjistrojë shpejt dhe lehtë dokumentacionin ku përfshihen faturat elektronike, faturat pa para ne dore, faturat me para ne dore, faturat shoqeruese dhe dhe veprimet e arkave.
- h) Të jetë i integruar me sistemin e faturimit.
- i) Faturat për të gjithë abonentët të merren automatikisht nga sistemi i faturimit dhe të fiskalizohen.
- j) Faturat për veprimet të cilat mund të mos përfshihen në sistemin e faturimit, si psh lidhje të reja, ndryshim emri etj. të ketë mundësi të regjistrohen manualisht.
- k) Të dërgojë në shërbimin e fiskalizimit pagesat e faturave elektronike, të cilat nuk raportohen nga bankat e nivelit te dyte.
- l) Të gjenerojë raporte dhe informacion mbi faturat të cilat janë fiskalizuar ose jo.

Operatori Ekonomik duhet te kete zgjidhjen e certifikuar të software-it në formën e një aplikacioni individual, ose një sistemi kompjuterik të integruar, ose një aplikacion Cloud, i cili mundëson:

- krijimin e një fature, një fature shoqëruese dhe vendosjen e të gjithë elementeve të nevojshëm;
- vlefshmërinë e operatorit që lëshon faturën ose faturën shoqëruese;
- dërgimin e sigurt të të dhënave në sistemin qendror, duke përdorur certifikatën elektronike;
- lëshimin dhe pranimin e faturave elektronike;
- transmetimin automatik të të dhënave në administratën tatimore dhe marrjen e mesazhit;
- konfirmues nga administrata tatimore, pas verifikimit automatik të secilës faturë individuale ose fature shoqëruese;
- ruajtjen e të dhënave të faturave ose të faturave shoqëruese;
- gjenerimin e numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF) dhe numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës shoqëruese (NSLFSH);
- gjenerimin e kodit QR;
- printimin e faturës ose thjesht kodit QR, në situata të përcaktuara në ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”;

-
- sigurojnë shkëmbimin e të dhënave në kohë reale dhe me autentifikim të sigurt të pajisjeve fiskale ekzistuese ose sistemit të fiskalizimit;

Funksione të tjera që duhet të ketë programi:

10. Bazat e të dhënave, të jenë të pa-aksesueshme jashtë këtij sistemi
11. Të ofroje mundësinë për të përcaktuar autorizime të detajuara se cili përdorues apo rol të mund të shikojë, administrojë llogari apo element ose ambiente të caktuara
12. Të ofrojë një mekanizëm për administrimin e privilegjeve në mënyrë të detajuar për funksionalitete të ndryshme. Në këtë mënyrë çdo përdorues ka akses vetëm tek ambientet, modulet apo raportet që i janë përcaktuar më parë nga një përdorues administrator.
13. Të ofroje mundësinë që një përdorues i caktuar të mund të shikojë vetëm veprimet e tij dhe jo veprimet e të tjerëve.
14. Të ofroje mundësinë për të përcaktuar autorizime të detajuara se cili përdorues apo rol të mund të shikojë, administrojë llogari apo element ose ambiente të caktuara
15. Të mundesojë regjistrimin e çdo krijimi, anulimi apo modifikimi dokumenti nga ana e përdoruesve.
16. Të mundesojë regjistrimin e datës, orës, përdoruesit dhe të IP-së së atij që ka kryer veprimin gjatë regjistrimit të auditimit.
17. Të mundesojë historikun e veprimeve, pra të mund të shihen dokumentet si kanë qenë para modifikimit.
18. Backup. Të dhënat të ruhen çdo ditë nëpërmjet një procesi automatik backup.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin Lista e Çmimeve të Shërbimeve, sipas Shtojcës 2.*

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare ku vlera e xhiros minimale vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme me një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues si më poshtë:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit D.P.A., ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- Çertifikatë ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit te cilesise”
- Çertifikatë ISO 20000 mbi “Menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit”
- Çertifikatë ISO 27001 mbi “Sistemet e menaxhimit te sigurise informatike”

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter duhet të përmbushet nga të gjithë operatorët e bashkimit.

